

TRASHËGIMIA (pjesa 2)

Familje Të Kënaqura

Jemi në pjesën e dytë të serisë “Trashëgimia”.

Familje të kënaqura, vlerat e duhura kur vjen puna te financat.

Uroj shumë që jetë inkurajim dhe që do të marrësh diçka specifike nga ky mesazh sot!

Se shiko, gati çdo çift, çdo familje e re fillon nga zero financiarisht. Të paktën kështu ka qenë për mua dhe gruan time.

Kush nga ju e ka filluar me zero?

I thosha gruas sime, “*Ne s’kemi lek zemër, por kemi dashuri*”.

Edhe sot po aty-aty jemi, por kemi përdorur atë që na ka besuar Perëndia për të ndërtuar familjen dhe për t’u shërbyer sa më shumë njerëzve.

Shkaku numër NJË i divorceve në familje vjen nga keqmenaxhimi i parave. Unë dhe gruaja ime, lavdi Zotit, jemi akoma bashkë edhe pse kemi kaluar shumë vite të vështira financiarisht. Pyetja që mbetet është:

Si Ta Drejtojmë Vetën Dhe Familjen Që Të Jemi Të Mençur Me Paratë?

Sepse ka shumë tundime për qark që të mendojmë vetëm për sot, çfarë të fitojmë sot. Te ky mesazh dua të theksoj tre gjëra.

Së pari t’i kujtojmë vetes gjithmonë këtë:

Perëndisë i Përket Çdo Gjë

Kjo është vlera e parë, bindja e parë, gjëja e parë për t’i kujtuar vetes, fëmijëve, gjithë familjes. Bibla thotë:

Psalmi 24:1 “*Zotit i përket toka dhe të gjitha gjërat që janë mbi të, bota dhe banorët e saj.*”

E di pse është shumë e rëndësishme për t’ua mësuar fëmijëve këtë gjë? Duket sikur po jetojmë në kohët sikur çdo gjë rrotullohet rreth fëmijëve. Unë i dua shumë fëmijët, shumë, shumë, mos më keqkuptoni, por pa e vënë re, po i vëmë fëmijët si qendrën e jetës dhe po i “adhurojmë” ata. Ata janë si shpirt, ne si prindër duam të bëjmë çdo gjë për ta, por edhe duam të jenë të fortë për jetën që do kenë përpara.

Prandaj le t’ua mësojmë sa më herët: **Çdo Gjë I Përket Zotit**. Nëse e kuptojnë këtë gjë, ata do e kenë idenë se qendra e botës është Zoti dhe jo ata. Kështu, ata fillojnë të mësojnë si të jenë falenderues ndaj Perëndisë për gjërat që u sjellin prindërit në shtëpi, apo ato që kanë tashmë.

Edhe ne, kur e kuptojmë se çdo gjë i përket Perëndisë, ndryshojmë të menduarit për financat. Kur e di se këto që kam, Perëndia m’i ka lënë t’i menaxhoj për sa kohë jam në tokë, por s’do i marr me vete. Po menaxhoj ato që më ka dhëne Ai të cilin e adhuroj dhe e dua fort dhe do ta menaxhoj sa më mirë çdo burim që më jep Ai.

Kur e ke ti të qartë, pastaj ky lloj qëndrimi do të përcillet edhe te fëmijët e tu gjithashtu.

Le të jetë kjo vlerë pjesë e trashëgimisë që do lësh pas!

Kur kishim makinën e parë, djalit tonë kur po rritej, i thoshim “Makina është e Zotit, Ai na e ka lënë ta përdorim. Jo vetëm makina, por edhe shtëpia, ti, jeta jonë i përkasin Atij”. Ai shikonte si i hutuar me ata sytë e vegjël që i shkëlqenin “*ça thonë këta*”.

Pra, vlera e parë, në lidhje me financat është vlerë që ta kemi të fortë vetë së pari, pastaj t’ua theksojmë fëmijëve. Le t’i kujtojmë vetes përditë: **Çdo Gjë e Imja i Përket Zotit**. Jeta nuk është e imja, i përket Atij. Çdo gjë e imja është e Tij. Mua më janë besuar për t’i menaxhuar ato.

E dyta, t’u mësojmë:

Vlerën e Punës—Rëndësinë e Punës

Ja një varg i fortë:

Fjalët e Urta 13:4 “*Shpirti i përtacit dëshiron dhe nuk ka asgjë, por shpirti i atyre që janë të kujdesshëm do të kënaqet plotësisht.*”

Ai që është i kujdesshëm, ai që është i zellshëm dhe punëtor do të begatohet. T’u mësojmë jo vetëm dëshirën për punë, por edhe që çdo gjë arrihet me punë. Paratë nuk vijnë nga portofoli i babit apo i mamit, por vijnë nga puna që po bëjnë ata. Duken kollaj kur t’i japin sepse dalin nga portofoli te ty, por është dashur shumë punë për t’i futur në portofol.

Mendo për ide se si mund ta bësh këtë gjë. Që fëmijët të mos i marrin gjërat “qyl”, por të bëjnë diçka për ta fituar.

Kur dy djemtë tanë ishin të vegjël, kishin tri punë në ditë që të merrnin 200 lek. I mblidhnin ato dhe blinin diçka.

Disa punë të tyre dhe një për të gjithë:

Rregullo krevatin! Çoje pjatën tënde te lavamani! Vëri këpucët gjithmonë në vend! Dhe një punë për të gjithë, që përfitonin të gjithë...

Më vonë kur u rritën ca edhe përgjegjësia rritej. Derisa do përgatisnin një mëngjes në javë për gjithë familjen. Dhe i krijon idenë fëmijës që në vegjëli: “Ti mund të arrish diçka që tani, ti mund të punosh drejt diçkaje.”

Ja si arrihet blerja e filan gjëje që do ti: Mbledh pak nga pak - babi të jep diçka kur ti bën diçka. Dhe kishim një fletë te frigoriferi që bënëin “check” çdo ditë të javës që i kishin bërë të gjitha. Është qejf kur i shikon të blejnë diçka me lekët e veta. Dhe gjithashtu ata kuptojnë që lekët mbarohen dhe duhet të bëjnë punë të tjera për të fituar më shumë.

Ne iu bëmë tri kavanoza: 10% Zotit, 10% kursim dhe 80% mund t’i prishësh si të duash. Ti do që ata të kuptojnë vargun te:

Fjalët e Urta 21:20 “*Në shtëpinë e të urtit ka një thesar të çmuar dhe vaj, por njeriu budalla i bën të gjitha rrush e kumbulla.*”

Të mençurit kursejnë, të marrët i prishin aq sa kanë.

Ka prindër që u mësojnë fëmijëve: “Kurse para dhe kur të bëhesh 18 vjeç do të jap aq sa ç’ke kursyer edhe ti, për të blerë makinën tënde.” Ndonjëri mund të thotë “Po ja kurseu fëmija 3-4 milion lek të vjetra (3-4 mijë euro), ku t’i gjej unë si prind?”. Fillo kurse dhe ti diçka për ta.

Ose kurse për shkollën, ose për telefonin, ose diçka tjetër, veç t’u mësosh të kursejnë, u bën mirë atyre. I mëson fëmijës durimin dhe etikën e punës. I meson: “Kurse sot, që të kënaqesh nesër.”

E treta që kanë nevojë të mësojnë fëmijët dhe ne vetë, ta kemi si vlerë që e trashëgojmë:

Vlera e Dhënies—Bujaria

Ndonjëri mund të thotë “Po, kjo është vlerë e jona tashmë, nëse je shqiptar, je edhe bujar. Sepse kemi fjalën e urtë ‘bukë e kripë e zemër të bardhë.’” Kjo është shumë e veçantë, por le të kujtojmë së pari që:

Ne jemi krijuar në imazhin e Krijuesit, Ai është dhënësi më bujar në botë. Nëse Ai dha, ne japim. Mos i jep fëmijëve rrugës për te kisha dy mijë lek për ta hedhur te koshi i ofërtës. Jo, jo. Të japin 10% e asaj që kanë fituar vetë. Nëse ka fituar dy mijë lek, le të japë dyqind lek. Nuk është puna te shuma, por është që të mësohet të jetë bujar. Dhe kanë për t’u bërë bujarë si Krishti, të jenë dorëhapur me gjërat që kanë.

Pra: Mësoju fëmijëve dhe vetes (për të rinjtë):

1. Perëndisë i përket çdo gjë;
2. Vlerën e punës dhe si ta shpenzojnë atë që fitojnë;
3. Si të japin.

Sepse materializmi “po na merr frymën”. Mënyra sesi thyhet materializmi është duke qenë bujar me ato që ke.

Duam që t’i kemi vetë të forta këto vlera së pari, pastaj t’ua japin atyre dhe ata t’i pasojnë te dikush tjetër.

Shiko, nuk jam kundra të të pasurit gjëra të mira, por jam kundra adhurimit të gjërave të mira. Kur mendon se “jeta është kot po s’pate këtë apo atë, jeta do jetë më e bukur kur të kem këtë e atë”. Shiko Bibla thotë:

1 Timoteut 6:6 “Perëndishmëria është një mjet që sjell dobi të madhe, kur njeriu kënaqet me aq sa ka.”

Nëse e mëson vetë dhe u mëson fëmijëve të kënaqen me atë që kanë, ta shijojnë atë që kanë, ti ke arritur një fitore të madhe. U ke dhënë ilaçin, i ke vaksinuar kundra rrymës së kësaj bote materialiste.

Të Jesh i Kënaqur = Vaksina

Sot po adhurohen gjërat. Sa më shumë gjëra ke, aq më i rëndësishëm je. Jo, jo. Ti je i rëndësishëm sepse je krijuar nga Perëndia, je blerë me gjakun e Krishtit, gjënë më të çmuar në botë. Gjërat, paratë, janë mjete, s’janë qëllim jete.

Njerëzit që janë të kënaqur, nuk kërkojnë ku është më e mira, por e krijojnë më të mirën me atë që kanë sot.

Kujt i ka ndodhur kjo kur ishte prind?

Një herë i blemë çunave një dhuratë për Krishtlindje dhe ata pasi e hapën, e panë dhe filluan të luanin me kutinë, jo me dhuratën.

Ty si prind, të vjen t’u thuash “Jooo, të keqen babi! Ja ta mësoj unë materializmin ty, mos luaj me kutinë, ajo s’ka kushtuar lekë. Luaj me këtë lodrën tjetër, se kjo ka kushtuar lekë”. Jo ore jo, lëre të krijojë më të mirën me atë që ka sot. Le të luajë me kutinë po i pëlqeu më shumë ajo.

Është bërë një studim, me dy djem. Njëri optimist dhe tjetri pesimist. Bënë dy dhoma prej xhami dhe ushtrimi ishte: Hodhën plot bajga kali te dhomat e secilit dhe i futën djemtë nëpër dhoma.

Dhe pas disa orësh, te dhoma e pesimistit, panë që djali ishte strukur në cep i tmerruar.

-Çfarë ke? - e pyetën.

-*Më keni vënë në një dhomë me bajgaaaa*, - dhe qante me të madhe.

Kurse te dhoma e optimistit, e gjetën djalin duke luajtur me bajgat e kalit, i hidhte nëpër mure dhe kërkonte vërdallë.

E pyeten: “Çfarë po bën?” Ai tha: “*Me gjithë këto bajga kali, po kërkoj se ku është fshehur poni, kali i vogël.*”

Të jesh i kënaqur varet nga ajo sesi i shikon ti gjërat.

Ja, të jap një element sesi mund të jesh i kënaqur - vjen kur shton mirënjohjen. Ji ti mirënjohës dhe mësoju fëmijëve të jenë mirënjohës dhe falenderues, sepse kjo do i bëjë gradualisht të jenë të kënaqur me atë që kanë. Fillon me gjërat e vogla, “*të lutem*”, “*faleminderit*”.

Sepse, më dëgjo pak, nëse nuk ka mirënjohje, do ketë atë qëndrimin tjetër, e di cilin?

“*Ma kanë për detyrë.*”

“Ma kanë për detyrë prindërit. Ma ka për detyrë burri/gruaja, motra/vëllai. Ma ka për detyrë mami të m’i bëjë rrobat gati, ushqimin gati, çantën gati.”

Është shenjë se mungon mirënjohja. Qëndrimi mirënjohës do mësohet sa më herët.

Ti vetë, ji mirënjohës për një gotë ujë që të ofron dikush, për një gjë të vogël. Fëmijët të shikojnë ty dhe bëjnë si ti.

Fillon me përlësinë. Për mua, i kujtoj vetes:

“*Kujt ia merrte mendja që, një katundar si unë, nga malësia e Tiranës, të krijonte një familje kaq të mirë dhe do të drejtonte një kishë kaq të veçantë sa ç’është kisha jonë?*”

Jam pa fjalë dhe vetëm mirënjohës ndaj Perëndisë.

Fillon me mirënjohjen: Ji falenderues dhe kjo prodhon përlësi, instaloje këtë “app” te vetja jote, pastaj te fëmijët e tu: Mirënjohës dhe Falenderues!

Nuk ka cilësi më të veçantë sa përlësia.

Krishtit ia kishin për detyrë t’i rrinin “pronto” të gjithë sepse ishte Krijuesi i gjithë njerëzimit.

Por Ai e përlësi veten, u shërbeu njerëzve që i kishte krijuar vetë.

Bota e shikon si dobësi, të jesh i përlësuar, por modeli ynë nuk është bota, është Krishti.

Para shumë vitesh, në verë ishim me një familje tjetër në pishinë dhe çunat ishin të vegjël. Djali im i madh ishte fëmijë dhe më leu shpinën me krem dhe prindi tjetër i tha të birit: “*Të keqen babi më lyej te shpina se nuk e arrij.*” - ai tha: “*Jo, se lyej. Pse çajam unë të lyej ty me krem, shërbëtori jot?*”

Djali im i tha: “A ta lyej unë?” Me shumë përlësi ia leu shpinën shokut tim. M’u mbush zemra me përlësinë e tij.

Përlësia vjen kur ti e di se kush je, kur e ke të qartë identitetin tënd dhe se kush është Perëndia dhe e di që ti s’je Perëndia. Perëndi është një “burrë” tjetër dhe nuk e lëshon vendin. Ne jemi njerëz, jemi të gjithë njëlloj. Ji i përlësuar vetë, mësojua përlësinë fëmijëve. Është vlerë e rrallë për t’u trashëguar, është xhevahir!

Nëse do që fëmija yt të jetë bujar, mësoju se çfarë të sjell bujaria. Bujaria e thyen egoizmin. Nëse fëmijët mësojnë të japin, po mësojnë të vendosin të tjerët para vetes, kjo e thyen egon.

Dhe kur miksohen bashkë “Mirënjohja, “Falenderimi” dhe “Përrulësia”, automatikisht krijohet ndjesia e të kënaqurit me atë që ke. Dhe bujaria është kyçe në këtë gjë.

Ishte një ushtrim me fëmijët e një kopshti:

Nëse do të kishe njëqind mijë lek, çfarë do të bëje?

Dhe fëmijët u mahnitën, “Njëqind mijë lek?”.

Pergjigjet e tyre ishin të cuditshme: *“Dua të blej një makineri që prodhon çdo gjë që dua unë.”* *“Do të blija një makinë të madhe me drita.”* *“Do të blija një pishinë të madhe.”* *“Do të blija një top të madh futbollit.”* *“Do të blija një pushkë.”* *“Do të blija një qen me një shtëpi të madhe.”*

Një nga fëmijët tha: *“Do ndihmoja të gjithë të varfërit e qytetit.”*

Auuuu ça zemre, që fëmijë! Mësoju fëmijëve të jenë të kënaqur me atë që kanë, mësoju të jenë bujarë, është element kyç i kënaqësisë. Kujtoju se çdo gjë i përket Perëndisë. Mësoju vlerën e punës dhe ilaçin që është të jenë të kënaqur me atë që kanë.

Dhe shikoni, prindër, janë gjëra që mësohen me të parë, jo me të thënë. Nëse do që fëmijët të jenë bujarë, ji ti bujar. Nëse do që fëmijët të jenë mirënjohës, ji ti mirënjohës. Nëse do që të jenë falenderues, ji ti falenderues. Nëse do që fëmijët të nderojnë Perëndinë, nderoje ti Perëndinë së pari. Dhe pak nga pak ata do e kapin, do nxënë duke të të parë ty.

(shembull personal:

Mendoj që bujarinë e kam mësuar nga mami im.

Ne jemi rritur në një familje shumë të varfër, ishim gjashtë fëmijë dhe me kushte jo të mira.

POR kur dikush vinte për të kërkuar diçka, nëse vinin romët apo dikush në nevojë, mami gjithmonë kishte diçka për t’u dhënë.

Se ku i gjente, se di, por kishte gjithmonë diçka për t’u dhënë: pak gjalpë, pak gjizë, disa vezë, disa patate. S’i linte duarbosh.)

Fëmijët mësojnë duke na parë ne.

Nëse do që të jenë bujarë, ji ti bujar!

Duket sikur ka dy ekstreme tek prinderit.

“Le t’i japim çdo gjë të voglit tonë, mos t’i hyjë asnjë gjemb në këmbë, të ketë çdo gjë gati.”

Por i vogli, bëhet i madh, bëhet 18 vjeç dhe vjen në shkollë në Tiranë/ jashtë shtetit, si do përballet me sfidat e jetës? Pastaj për çdo gjë merr mamin në telefon: *“Ta dish moj mami sa e vështirë është jeta këtu, a do vish edhe ti këtu, të jetojmë bashkë, se këtu të ha ujku vetëm.”* Dhe mami detyron babin të shesin çdo gjë, vendin ku janë, shkojnë me qira kudo ku është fëmija, që t’i rrinë afër djalit të vogël 20 vjeç+ që po lodhet shumë, duke u ulur 20-30 herë nga njëra kafe te tjetra!

Ose ekstremi tjetër: Kur u thua *“JO”* për çdo gjë fëmijëve. *“Jo, jo, nuk bën. Jo, nuk ka. Jo, jo nuk ta marr. Jo, jo, jo!”*

A ka diçka të mesme? Mendoj që unë dhe gruaja ime jemi nga mesi shumicën e herëve, por shpesh kalojmë një herë në një anë, një herë në tjetrën.

Kur je i kënaqur me atë që ke, je i qetë për të kursyer, je i qetë për të dhënë dhe nuk vrapon për të hyrë në borxhe.

Pastaj rriten “zogjtë e vegjël”, u dalin krahët dhe fluturojnë. Atëherë ti bën si Moisiu. U thua: “Tani është zgjedhja jote, ja ku e ke. Kjo Është Rruga E Jetës, Kjo Është Rruga E Shkatërrimit, zgjidh kë të duash, sepse këtu mbaron puna ime si prind”.

Ligji i Përtërirë 30:19 *“Unë marr sot si dëshmitarë kundër teje qiellin dhe tokën, që unë të kam vënë përpara jetës dhe vdekjes, bekimit dhe mallkimit; zgjidh, pra, jetën që të mund të jetoni ti dhe pasardhësit e tu.”*

Mënyra sesi jemi rritur na ndikon si sillemi me financat dhe shumë sjellje të tjera. A duam të bëjmë diçka ndryshe nga prindërit tanë? Një vlerë të re që s’e kishin?

Për ta mbyllur:

Shiko, asnjëri prej nesh nuk është prind i përsosur, as bir i përsosur dhe as bijë e përsosur.

Por për shkak të Jezusit, kemi marrë dhe marrim hir,

falje dhe mëshirë çdo ditë. Madje hir mbi hir. Hir, do të thotë se na jepet një mundësi e re, çdo ditë, çdo javë.

Ti, unë, ne mund të bëjmë diçka për të lënë një trashëgimi siç duhet me vlerat e duhura. Krishti Jezus, na ndryshon dhe na transformon. Trashëgimia jonë ka ndryshuar, që në momentin që zgjodhëm Krishtin Jezus.

Disa hapa praktikë që mund të ndiqni:

-Lexoni Biblën si familje;

-Flisni për dhënien, kursimin, shpenzimet ;

-Mësojuni fëmijëve diçka ndryshe për kursimin, ndoshta për një ëndërr të tyre.

Çfarë është një gjë praktike se si mund të jesh ti vetë, ose si familje më i kënaqur me jetën dhe gjërat që ke?

Filloje me mirënjohjen, falenderimin ose bujarinë.

Le të lutemi